

më vija në partinë komuniste, mbi lulëzimin e njëqind luleve e konkurrimit e njëqind shkollave në revolucion e në socializëm.

Në Shqipërinë socialiste bashkimi vullnetar i drejtpërdrejtë i popullit në Frontin Demokratik, nën udhëheqjen e vetme të Partisë së Punës të Shqipërisë, mbetet kurdoherë garanci për ruajtjen e fitoreve të mëdha revolucionare të arritura dhe për fitore të reja në rrugën e socializmit e të komunizmit.

### 3. LËVIZJET E MËDHA REVOLUCIONARE

Fjala e shokut Enver Hoxha e 6 shkurtit 1967 dhe gjithë lufta e Partisë për të vënë në jetë vendimet e Kongresit V i dhanë edhe më shumë zjarr veprimtarisë revolucionare të masave punonjëse. I madh e i vogël u ngrit në këmbë, duke kritikuar me guxim veten dhe të tjerët, për të luftuar të metat, dobësitë e gabimet, për të spastruar shoqërinë socialiste nga mbeturinat e shoqërisë së vjetër dhe nga ndikimet e ideologjisë borgjezo-revizioniste, për të rrënjësuar në punë e në jetë normat e qëndrimet revolucionare socialiste, mësimet proletare të Partisë. Shpërthyen iniciativa të mrekullueshme të punonjësve, që u mishëruan në një shumicë aksionesh konkrete, u shndërruan në lëvizje të mëdha revolucionare.

Këto lëvizje ishin një rrjedhim i drejtpërdrejtë i vijës marksiste-leniniste, i tërë punës e luftës revolucionare të Partisë, të mëparshme dhe aktuale, për zhvillimin e pandërprerë të revolucionit socialist.

Në krye të këtyre lëvizjeve qëndronte klasa punëtore me partinë e saj marksiste-leniniste.

#### **Lëvizja për të vënë gjithkund interesin e përgjithshëm mbi interesin vetjak**

Thelbi i kësaj lëvizjeje ishte sulmi i përgjithshëm kundër psikologjisë mikroborgjeze për rritjen e ndër-

gjegjes socialiste të punonjësve.

Duke u mbështetur në përparimin e madh të arritur pas Çlirimit në formimin e njeriut të ri me botëkuptimin revolucionar, Partia e quante të domosdoshme t'i jepte një shtytje të re të fuqishme luftës kundër koncepteve e qëndrimeve mikroborgjeze, të cilat përbëjnë një pengesë të madhe në rrugën e

zhvillimit socialist, si edhe kundër bazës materiale që i ushqente ato, sido që kjo bazë tashmë paraqitej shumë e ngushtë.

Shprehja më karakteristike e psikologjisë mikroborgjeze ishte prirja e tërheqjes pas interesit të ngushtë vetjak. Pikërisht për këtë arsye, në luftën kundër kësaj psikologjie objektiv kryesor u caktua forcimi i ndjenjës për të vënë interesin e përgjithshëm mbi interesin vetjak.

Lëvizja për të vënë gjithkund interesin e përgjithshëm mbi interesin vetjak u zhvillua në shumë drejtime e në shumë forma.

Klasa punëtore ndërmoi iniciativa për të arritur me anë të një mobilizimi më të madh e të një pune vetëmohuese dy-tre vjet përpara treguesit kryesorë ekonomikë të planifikuar për vitin 1970, pa prekur rezervat shtetërore të sigurimit dhe pa harxhuar mbi planin lëndë të parë e artikuj të importuar etj. U rishikuan normat e vjetra në proceset e ndryshme të prodhimit, që kishin ngelur prapa përparimit të gjithanshëm të forcave prodhuese dhe u vendosën norma të reja më të përsosura, më mobilizuese. Punëtorë të pararojës kaluan në brigada të prapambetura për t'i çuar edhe ato përpara.

Iniciativa më e madhe revolucionare në fshat ishte zvogëlimi i oborreve të kooperativistëve. Në të gjitha kooperativat ngastrat e tokës së oborreve u shkurtuan në masën 50-66 për qind, kurse bagëtia e oborreve në masën 50 për qind. Në kooperativat e zonave fushore zvogëlimi ishte edhe më i madh. Kjo masë, që u ndërmor në bazë të vullnetit të lirë të kooperativistëve, iu përgjigj orientimit të Kongresit V të Partisë për zvogëlimin shkallë-shkallë të oborrit përpjesëtimisht me rritjen e mundësive të ekonomisë kolektive për të përballuar nevojat për jetesë të familjes kooperativiste. Ajo ushtronte një ndikim të fuqishëm për çrrënjosjen e psikologjisë prej pronari të vogël të fshatarëve, për forcimin e ndjenjës së kolektivizimit dhe për lidhjen e tyre më fort me pronën e përbashkët, që përbënte burimin kryesor të jetesës e të mirëqenies së kooperativistit.

Në valën e lëvizjes për të vënë mbi gjithçka interesin e përgjithshëm lindën iniciativa për zgjerimin dhe për organizimin më të shëndoshë të pjesëmarrjes së kuadrove dhe të gjithë inteligjencies në prodhim. Kjo solli forcimin e lidhjeve të kuadrove drejtues dhe të punonjësve të administratës me masat, njohjen më thellë nga ana e tyre të problemeve ekonomi-

ko-shoqërore e të vetë jetës, kalitjen e tyre të mëtejshme revolucionare, përmirësimin e metodës e të stilit në punën e drejtimit. Kjo shënonte njëkohësisht një hap përpara drejt ngushtimit gjithnjë e më shumë të dallimit thelbësor midis punës mendore e punës fizike.

Shfaqje të patriotizmit socialist, të vënies së interesit të përgjithshëm mbi interesin vetjak ishin iniciativat e punëtorëve dhe të inteligjencies për të hequr dorë nga honoraret, nga shumë shpërblime plotësuese dhe të ardhura të tjera mbi rrogën bazë; iniciativa për t'ia falur shtetit obligacionet e huave shtetërore; iniciativa e kooperativistëve për t'ia falur kooperativës këstet e parave për bagëtitë vetjake që i kishin dorëzuar asaj.

Shkolla të mëdha edukimi revolucionar u bënë aksionet kombëtare dhe lokale të rinisë. Dhjetëra mijë vullnetarë të rinj e të reja, nxënës e studentë, punëtorë e kooperativistë, duke punuar në aksione me frymë të lartë revolucionare, mësuan si ta duan më shumë punën, si ta duan më tepër shokun, si ta bëjnë më frytdhënëse luftën për asgjësimin e së vjetrës dhe përhapjen e rrënjosjen e së resë, si t'i shërbejnë më mirë atdheut e socializmit.

Përfundimet e shkëlqyera të lëvizjes për të vënë interesin e përgjithshëm mbi interesin vetjak nuk u arritën pa vështirësi, pa ndeshje të ashpra midis së resë, përparimtares dhe së vjetrës, reaksionares. Për shkak të rrënjëve të thella që ka psikologjia mikroborgjeze, ndjenja e pronës private, kishte njerëz, në qytet e në fshat, që nuk ecnin me të njëjtin hap të shumicës dërrmuese të punonjësve për zbatimin e iniciativave revolucionare. Të prirë nga interesi i ngushtë vetjak, shfaqnin ngurrime e lëkundje, duke u bërë kështu pengesë.

Pengesat e vështirësitë që u hasën u kapërcyen me forcën e kolektivitetit, me luftën ideologjike të Partisë, me punën bindëse të saj.

Drejtperdrejt e nëpërmjet levave të saj, Partia i mbështeti me të gjitha fuqitë iniciativat revolucionare dhe siguroi që ato të përhapeshin në mbarë vendin e të zhvilloheshin më tej. Ajo bëri një punë të madhe që lufta kundër vënies së interesit vetjak mbi interesin e përgjithshëm të kuptohej si një problem i madh me rëndësi ideologjike e shoqërore. Njëkohësisht goditi shkelje të veçuara të parimit të vullnetarizmit e të bindjes në përqaftimin e këtyre iniciativave revolucionare dhe mënjanoi

çdo shtrebbërim të tyre, duke e bërë të qartë se lufta nuk zhvillohej për të mohuar ose për të zhdukur krejt interesin vetjak, por për kombinimin e drejtë të tij me interesin e përgjithshëm, për t'ia nënshtuar interesin vetjak interesit të përgjithshëm.

Në zhvillimin dhe thellimin e mëtejshëm të lëvizjes për të vënë gjithkund interesin e përgjithshëm mbi interesin vetjak një rol të veçantë luajti **Deklarata e KQ të PPSH dhe e Këshillit të Ministrave të RPSH e 29 prillit 1967.**

Në Deklaratë përgjithësoheshin dhe ligjësoheshin iniciativat revolucionare. Njëkohësisht, duke u mbështetur në këto iniciativa, Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave shpallën marrjen e një vargu masash me karakter ekonomiko-shoqëror, që krijonin kushte më të mira për të forcuar bindjen ideologjike të punonjësve në rrugën e thellimit të lëvizjes për të vënë mbi gjithçka interesin e përgjithshëm.

U bë përsosja e mëtejshme e organizimit socialist të punës e të pagave.

Duke u nisur nga fakti që në procesin e ndërtimit socialist stimujt moralë fitojnë epërsi gjithnjë e më të madhe kundrejt stimujve materialë, Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave vendosën të hiqeshin ata stimuj materialë që çonin në krijimin e shtresave të privilegjuara. U bë një ulje e mëtejshme e pagave të larta. Të gjitha kursimet që erdhën nga këto veprime iu kthyen prapë punonjësve nëpërmjet rregullimit të pagave të ulëta dhe rritjes së shpenzimeve nga shteti për kopshtet e çerdhet e fëmijëve, nëpërmjet heqjes së tatimit mbi të ardhurat e gjithë punonjësve si edhe nëpërmjet një vargu masash në dobi të fshatarësisë kooperativiste. Tokat e bagëtia, të grumbulluara nga zvogëlimi i oborreve të kooperativistëve, do të përdroreshin tërësisht ose pjesërisht për të plotësuar nevojat për produkte bujqësore të familjeve të tyre.

Masat për përsosjen e mëtejshme të organizimit të punës e të sistemit të pagave nuk prekën parimin-bazë socialist të shpërndarjes sipas punës. Ato vetëm shërbenin si një mjet për t'u prerë rrugën individualizmit, egoizmit dhe të këqijave të tjera për shoqërinë socialiste.

Revolucionarizimi i mëtejshëm i mendimit të njerëzve sollar çlirimin e energjive dhe forcave të reja krijuese që nuk

ishin llogaritur më parë në hartimin e planeve perspektive ekonomike.

Një përvojë të mrekullueshme të paparë dha ndërtimi brenda 25 ditëve i më tepër se 6300 shtëpive dhe ndërtesave të tjera të shkatërruara ose të dëmtuara rëndë nga tërmeti i nëntorit 1967 në rrethet e Dibrës e të Librazhdit. Mbi bazën e kësaj përvoje lindën aksionet me goditje të përqendruar, një formë e re revolucionare aksionesh, me anën e të cilave brenda një kohe të shkurtër kryhet një punë relativisht shumë e madhe.

Kjo gjendje shtroi para organeve të Partisë e të shtetit domosdoshmërinë e rishikimit të planeve për t'iu përgjigjur vrullit revolucionar të masave. Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë mori në dhjetor 1967 vendimin e guximshëm për të elektrifikuar krejt fshatrat e vendit deri më 8 nëntor 1971, me rastin e 30-vjetorit të themelimit të PPSH, domethënë 14 vjet përpara afatit që parashikonte plani perspektiv i shtetit.

Lëvizja për të vënë gjithkund interesin e përgjithshëm mbi interesin vetjak e ngriti në një shkallë të re patriotizmin socialist të popullit.

Në rastet kur ndonjë punonjës binte në krye të detyrës për ndërtimin socialist ose mbrojtjen e atdheut, vendin e mbetur bosh e zinin menjëherë prindët, të afërmit e të tjerë, duke shprehur kështu një ndjenjë të lartë atdhedashurie me përmbajtje të thellë revolucionare. Për të zëvendësuar Shkurte Pal Vatën, vajzën 15-vjeçare nga Dukagjini, që ra në ndërtimin e hekurudhës Rrogozhinë-Fier, shkuan disa mijëra të rinj e të reja nga të katër anët e atdheut.

Kjo atdhedashuri gjeti shprehjen e vet edhe në ndihmën vëllazërore socialiste për njëri-tjetrin. Një ndihmë të tillë u dhanë vëllezërve të tyre të rretheve të Dibrës e të Librazhdit punonjësit e rretheve të tjera të Shqipërisë për të përballuar pasojat e tërmetit. Kjo i dha shkas iniciativës së re, që u përhap në gjithë vendin, për ndërtimin e shtëpive të banimit me kontribut vullnetar.

Një kuptim të madh revolucionar kishte sidomos përhapja e iniciativës për t'u dhënë falas kooperativave të zonave të thella malore një numër mjaft të madh bagëtish nga kooperativat bujqësore më të pasura dhe nga ndërmarrjet bujqësore shtetërore. Kjo iniciativë, që u pasua nga lëvizja Jug-Veri për ndihmë reciproke dhe shkëmbim përvoje midis kooperativave bujqësore, tregonte se përparimi e mirëqenia e çdo kooperative

janë të pandara nga përparimi e mirëqenia e gjithë fshatarësi-së kooperativiste, si në fushë ashtu edhe në malësi, si në Jug ashtu edhe në Veri.

**Lëvizja kundër fesë, Partia e Punës e Shqipërisë**  
**paragjykimeve fetare dhe ka zhvilluar kurdoherë një**  
**zakoneve prapanike luftë sistematike kundër fe-**  
**së, si ideologji e klasave**  
shfrytëzuese, armike e socializmit, si opium për popullin. Luftën kundër fesë, kundër paragjykimeve fetare, kundër zakoneve prapanike të lidhura drejtpërdrejt ose tërthorazi me fenë, Partia e ka parë si një mjet të domosdoshëm për çlirimin shoqëror të punonjësve, për kalitjen revolucionare ideologjike të tyre, për ndërtimin e shoqërisë socialiste. Nga ana tjetër, luftën për zhdukjen e shtypjes e të shfrytëzimit ekonomiko-shoqëror të lidhur ngushtë me zhvillimin e ekonomisë e të kulturës mbi baza socialiste, ajo e ka parë si kushtin e parë të domosdoshëm për çlirimin e punonjësve nga skllavëria shpirtërore e fesë. Në luftën kundër fesë dhe zakoneve prapanike ajo ka përdorur mjete e forma revolucionare që kanë ndryshuar sipas kushteve historike dhe gjendjes reale të besimeve fetare në vend, sipas etapave të revolucionit dhe shkallës së ndërgjegjes socialiste të punonjësve. Në këtë luftë ajo është udhëhequr vazhdimisht nga parimi që njerëzit të bindeshin nga vetë përvoja e tyre në kotësinë e fesë dhe në dëmin që i sjell ajo shoqërisë socialiste.

Fetë e ndryshme në Shqipëri dhe klerin përkatës i kanë përdorur pushtuesit për ta përçarë e për ta robëruar popullin. Për këtë arsye lufta çlirimtare shekullore e shqiptarëve kundër sundimit dhe shtypësve të huaj është drejtuar edhe kundër klerit reaksionar, që ka qenë vegël e tyre. Kjo ka bërë që populli shqiptar të mos ketë qenë i lidhur fort me fetë, të mos ketë qenë aq fanatik, që kleri të mos ketë pasur atë ndikim në masat popullore si në shumë vende të tjera. Ky fakt e ka lehtësuar luftën e Partisë kundër ideologjisë fetare dhe kundër klerit reaksionar.

Gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare Partia i asgjësoi përpjekjet e pushtuesve italianë e gjermanë dhe të tradhtarëve të vendit për të përçarë popullin në myslimanë e të krishterë. Ajo demaskoi dhe shkatërroi orvatjet e klerit të lartë,

sidomos katolik, për të shkëputur masat popullore nga Partia dhe nga Fronti Nacionalçlirimtar.

Pas Çlirimit dështuan gjithashtu përpjekjet e klerikëve reaksionarë dhe të armiqve të tjerë të klasës për të penguar ndërtimin socialist të vendit me anën e «fjalës së zotit». Këto përpjekje nuk gjetën mbështetje te masat. Populli dëgjonte e zbatonte fjalën e Partisë.

Qysh me shpalljen e Republikës Popullore, me anë të Kushtetutës u shpall ndarja e kishës nga shteti dhe e shkollës nga kisha, u ndalua përdorimi i kishës e i fesë për qëllime politike si edhe krijimi i organizatave politike mbi baza fetare. Me ligj u shpronësuan institucionet fetare nga pjesa më e madhe e tokave dhe e pasurive të tjera. U ndalua botimi i letërsisë fetare, u kufizua dhe, më pas, u hoqën mundësitë për përgatitjen e kuadrit fetar. Megjithatë, Partia dhe shteti nuk ndaluan besimet fetare, praninë e komuniteteve fetare, ushtrimin e riteve fetare. As mund të ndalonin ato zakone të lidhura me fenë, ndonëse në thelb reaksionare, që nuk përbënin shkelje të drejtpërdrejtë të ligjeve të shtetit. Partia nuk mund të fyente ndjenjat e një mase punonjësish, sidomos në fshat, që ishin lidhur ngushtë me Partinë dhe me pushtetin popullor, por që vazhdonin të besonin në njërin ose tjetrën fe, megjithëse nuk tregonin ndonjë fanatizëm të tepruar. Çrënjësja e botëkuptimit fetar do të vinte si pasojë e bindjeve ideologjike të masave.

Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe ndërtimi socialist i vendit kanë qenë në vetvete një shkollë e madhe edhe për edukimin ateist të punonjësve. Ato u kanë mësuar njerëzve se liria dhe pavarësia, përparimi dhe begatia nuk vijnë nga lutjet e nuk falen nga «zoti», por fitohen me luftë e me përpjekje të vetë njerëzve, janë vepër e masave popullore. Njëkohësisht, për të çliruar njerëzit nga besimet fetare dhe zakonet prapanike Partia ka zhvilluar një propagandë të gjerë ateisto-shkencore nëpërmjet shtypit e radios, librave, leksioneve e bisedave, filmave kinematografikë etj. Rol të madh ka luajtur shkolla duke përhapur kulturën, arsimin, njohuritë shkencore.

Tani qenë krijuar kushtet për të kaluar në një shkallë më të lartë të luftës kundër fesë, paragjykimeve fetare dhe zakoneve prapanike. Pas Kongresit V dhe fjalës së shokut Enver Hoxha të 6 shkurtit 1967, kjo luftë filloi në front të

gjerë dhe mori karakterin e një lëvizjeje të madhe me përmbajtje të thellë ideologjike. Ajo përfshiu të gjitha shtresat e popullit, veçanërisht rininë, por edhe njerëzit e moshave të kaluara. Ajo u drejtua me aksione konkrete jo vetëm kundër botëkuptimit reaksionar fetar, por edhe kundër çdo baze materiale që ruante dhe ushqente fenë e zakonet prapanike.

Në qytetet e fshatrat rinia dhe masat e tjera popullore u ngritën më këmbë duke kërkuar që kishat e xhamitë, teqetë e manastiret, të gjitha «vendet e shenjta» të mbylleshin; që klerikët të hiqnin dorë nga jeta parazite e të ktheheshin në punonjës duke jetuar, si të gjithë, me punën e mundin e tyre. Në mbledhje e kuvende popullore, të organizuara nga Fronti Demokratik dhe Bashkimi i Rinisë, ku zhvilloheshin diskutime të zjarra, populli dënonte rolin antikombëtar dhe antipopullor të fesë e të klerit reaksionar, të zakoneve fetare, vendoste për zhdukjen e vatrave fetare dhe shndërrimin e tyre në vatra kulture etj., për heqjen dorë nga ritet fetare dhe nga zakonet prapanike, për spastrimin e shtëpive nga ikonat, nga librat dhe simbole të tjera fetare.

Këto iniciativa të popullit u mbështetën fuqimisht nga organizatat e partisë dhe nga organet e pushtetit popullor.

Me prishjen e vatrave fetare u shkatërruan baza të rëndësishme që helmonin ndërgjegjen e njerëzve, që shërbenin edhe si çerdhe për punë armiqësore.

**Shqipëria u bë kështu vendi i parë në botë pa kisha e pa xhami, pa priftërinj e pa hoxhallarë.**

Duke mbështetur lëvizjen popullore të luftës kundër fesë, kundër paragjykimeve fetare dhe zakoneve prapanike, Partia e udhëhiqte atë me kujdes. Ajo nuk lejonte të bëheshin shtrembërime dhe mënjanoi me kohë çdo veprim të nxituar e të papabazuar në vullnetin e masës së popullsisë. Ajo e orientoi popullin që të kremtet dhe zakonet e tjera të lidhura me fenë t'i zëvendësonte me festa, me zakone e me norma të reja me përmbajtje socialiste. Aksionet e masave për prishjen e bazave të fesë u shoqëruan me një punë të dendur sqaruese dhe ateist-shkencore të partisë.

Komiteti Qendror i udhëzoi organizatat e partisë të luftohej çdo kuptim i ngushtë i problemit të luftës kundër fesë, çdo shfaqje vetëkënaqësie të rrjedhur nga përfundimet e shkëlqyera që u arritën brenda një kohe fare të shkurtër në prishjen



e vatrave fetare. Zhdukja e kishave dhe xhamiye nuk e kishte zhdukur fenë si botëkuptim. Feja i ka rrënjët shumë të thella. Ajo është përzier, është lidhur me një mijë fije me zakonet prapanike që e kanë burimin ndër shekujt e largët, që jetojnë dhe veprojnë për një kohë shumë të gjatë. Për këtë arsye ishte e nevojshme që zakoneve prapanike, praktikave dhe dogmave fetare t'u zbulohet burimi, baza e tyre filozofike idealiste, reaksionare e të luftohej për shkatërrimin e kësaj baze. «Ne duhet të jemi realistë, — mësonte shoku Enver Hoxha, — lufta kundër zakoneve, traditave, normave të vjetra, kundër botëkuptimeve fetare. . . nuk ka marrë fund. Kjo është një luftë e gjatë, e ndërlikuar dhe e vështirë»<sup>1</sup>.

Krahas punës edukuese, qëllimit të zhdukjes së paragjy-kimeve fetare dhe rrënjësjes së botëkuptimit materialist revolucionar në ndërgjegjen e njerëzve i shërbente krijimi i të gjitha kushteve përkatëse materiale e morale në procesin revolucionar të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste.

### Lëvizja për çlirimin e plotë të gruas

Kushtrimin e kësaj lëvizjeje e dha shoku Enver Hoxha më 6 shkurt

1967: «Gjithë Partia dhe vendi duhet të ngrihen në këmbë, të djegin me zjarr zakonet prapanike e t'i këpusin kokën cilitdo që merr nëpër këmbë ligjin e shenjtë të Partisë për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe të vajzave»<sup>2</sup>.

Për të vënë në jetë direktivën e Partisë për çlirimin e plotë të gruas u ngritën më këmbë organizatat e partisë dhe, nën udhëheqjen e tyre, organizatat e Bashkimit të Grave, të Frontit Demokratik, të Bashkimeve Profesionale, të Bashkimit të Rinisë. Lëvizja ishte aq e fuqishme sa përfshiu edhe shtresa të atilla shoqërore që më parë qëndronin indiferente ose në pozita konservatore për sa i përket çlirimit të gruas. Në mbledhje e kuvende të gjera, që u organizuan në të katër anët e vendit, të rinj e të reja, burra e gra, pleq e plaka dënonin me guxim zakonet dhe pikëpamjet konservatore, patriarkale, feudale dhe borgjeze, besimet fetare, kanonet mesjetare që kishin

1 Enver Hoxha. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 206-207.

2 Enver Hoxha. Fjala e 6 shkurtit 1967. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 8.

shërbyer si mjet për skllavërimin e gruas shqiptare në të kaluarën. Masat popullore vendosnin njëzëri dhe i jepnin fjalën Partisë se do të shkelmonin përgjithmonë mbeturinat e zakoneve dhe të kanuneve barbare. Rëndësi të jashtëzakonshme kishte pjesëmarrja e gjallë, si kurrë ndonjëherë tjetër, e vetë grave në luftën për çlirimin e plotë të tyre. Për të parën herë u ngritën me një forcë aq të madhe në këtë luftë gratë e të rejtat e malësive dhe të të gjitha atyre krahinave të vendit, ku pesha e zakoneve, e kanuneve dhe e paragjykimeve fetare kishte rënduar si plumb mbi shpinën e tyre. Lëvizja për barazi të plotë midis burrit e gruas, midis djemve dhe vajzave filloi të zhvillohej edhe brenda në familje.

Shpërthimi i lëvizjes për çlirimin e plotë të gruas ishte rrjedhim i drejtpërdrejtë e i natyrshëm i luftës dhe i punës së madhe që kishte bërë Partia vazhdimisht qysh prej themelimit të saj. Partia u kishte treguar grave shqiptare se rruga e vetme për çlirimin e tyre ishte pjesëmarrja sa më e gjerë dhe më e gjallë në luftën e popullit për çlirimin kombëtar dhe shoqëror, për zhdukjen e çdo shtypjeje dhe shfrytëzimi, në jetën politike e shoqërore, në punën për ndërtimin socialist të vendit.

Duke vënë në jetë mësimet e Partisë, gruaja shqiptare fitoi me gjak të drejtat e barabarta me burrin, duke marrë pjesë gjallërisht në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Nën udhëheqjen e Partisë, gruaja shqiptare, e çliruar nga shtypja dhe shfrytëzimi klasor, si gjithë punonjësit e tjerë, u bë një forcë e madhe në të tëra fushat e ndërtimit të shoqërisë socialiste. Përparimet e arritura në rrugën e çlirimit të plotë të gruas shqiptare brenda pak më shumë se dy dhjetëvjeçarëve kanë qenë kolosale, po të merret parasysh se përpara kësaj kohe shumica dërrmuese e grave kishin qenë si skllave, se 90 e ca për qind e grave kanë qenë analfabete.

Me gjithë përparimet, Partia ishte e ndërgjegjshme se mbetej shumë për të bërë për çlirimin e plotë të gruas.

Duke e shikuar çlirimin e plotë të gruas si një problem jashtëzakonisht të madh shoqëror, pa zgjidhjen e të cilit «nuk mund të mendohet liria e popullit dhe e gjithsecilit, nuk mund të mendohen përparimi i vendit dhe arritja e qëllimeve tona»,<sup>1</sup>

---

1 Dokumente kryesore të PPSH, vëll. V, f. 260.

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë e mori në shqyrtim këtë problem në një mbledhje të posaçme që u mbajt në qershor 1967.

Plenumi përcaktoi orientimet për thellimin e mëtejshëm të lëvizjes për çlirimin e plotë të gruas dhe për rritjen e rolit të saj në shoqërinë socialiste.

Komiteti Qendror i Partisë ritheksoi se rruga kryesore për të siguruar çlirimin e plotë të gruas është tërheqja sa më e gjerë e saj në punën prodhuese dhe në jetën politike, shoqërore e kulturore.

Për zbatimin e direktivave të Komitetit Qendror u mobilizua gjithë Partia me pushtetin popullor e me organizatat shoqërore.

Suksesi i arritur gjatë viteve të diktaturës së proletariaut në pjesëmarrjen e grave në punë u zhvillua dhe u thellua më tej. Në vitin 1971 gratë përbënin 45 për qind të të gjithë punonjësve të vendit. Ky problem, që ka një rëndësi vendimtare për çlirimin e gruas, mund të quhej tashmë i zgjidhur. 48,8% në prodh

Përparime u shënuan edhe në pjesëmarrjen e gruas në jetën politiko-shoqërore. U rrit në mënyrë të dukshme numri i grave deputete dhe këshilltare. Më 1970 ato përfaqësonin 42 për qind të anëtarëve në organet e zgjedhura të pushtetit shtetëror. Më shumë se në çdo periudhë tjetër u shtua numri i grave komuniste. Më 1971 ato përbënin 22,05 për qind të efektivit të komunistëve kundrejt 12,47 për qind më 1966. Në të njëjtën periudhë u rrit edhe numri i shoqeve në plenumet e komiteteve të partisë nga 8 për qind në 25,1 për qind.

Komiteti Qendror kërkonte të bëhej kthesë në ngritjen e grave në përgjegjësi për të siguruar një pjesëmarrje më të gjerë në drejtim, si në fushën e prodhimit ashtu edhe në fushën e veprimtarisë politiko-shoqërore e kulturore me pikësynim që të arrihej edhe në këtë pikëpamje barazia e gruas me burrin. Por këtu mbetej për të bërë shumë punë e luftë, për të kapërcyer shumë pengesa derisa të arrihej ky pikësynim.

A) Një pengesë të madhe përbënin konceptet e vjetra përçmuese për gruan, që kanë rrënjë të thella në ndërgjegjen e njerëzve, më shumë te burrat, por edhe te vetë gratë. Partia e quante të domosdoshme në radhë të parë të luftohej kundër këtyre koncepteve më me këmbëngulje, më me ashpërsi dhe në mënyrë më sistematike.

14 Pengesë tjetër ishte niveli më i ulët kulturoro-arsimor dhe tekniko-profesional i grave në krahasim me burrat. Për të kapërcyer këtë pengesë Komiteti Qendror ngarkoi organet e partisë e të pushtetit të siguronin që të gjitha vajzat të mbaronin shkollat tetëvjeçare në bazë të ligjit të detyrimit shkollor dhe që të ndiqnin shkollën e mesme të arsimit të përgjithshëm një numër sa më i madh i tyre, t'i jepej përparësi dërgimit të vajzave në shkollat profesionale e të larta. Ai udhëzoi të punohej njëkohësisht për një pjesëmarrje sa më të gjerë të grave në shkollat pa shkëputje nga puna si edhe në kurse kualifikimi. Si pasojë e masave që u morën për zbatimin e kësaj direktive u ngrit përbindja e grave të shkolluara. Në vitin 1971 gratë zinin 43 për qind të punonjësve me arsim të mesëm e të lartë. Vetëm mjeke dhe inxhinierë numëroheshin më shumë se sa kishte vajza që ndiqnin shkollat unike e të mesme më 1938. Por që të arrihej barazimi i nivelit arsimoro-kulturor dhe tekniko-profesional i grave me atë të burrave, natyrisht, do të nevojitej ende shumë kohë.

15 Një pengesë tjetër shumë e madhe për të fituar gruaja barazinë e plotë me burrin vazhdonin të ishin punët shtëpiake. Klasikët e marksizëm-leninizmit kanë parashikuar se gruaja do të çlirohet plotësisht nga skllavëria e këtyre punëve vetëm me shoqërizimin e ekonomisë shtëpiake, me shndërrimin e kësaj ekonomie në degë të prodhimit shoqëror. Por kjo është një punë e ndërlikuar, kërkon një bazë materialo-teknike shumë të zhvilluar të socializmit, mjete materiale e financiare aq të shumta sa shteti socialist për një kohë të gjatë nuk është në gjendje t'i përballojë të gjitha. Pa prituri që të kryhet plotësisht shoqërizimi i ekonomisë shtëpiake, për çlirimin e gruas nga barra e rëndë e punëve të shtëpisë Partia kërkonte të punohej me një vendosmëri më të madhe në dy drejtime kryesore. (Së pari) çdo burrë ta ndiente si një detyrim shoqëror të merrte pjesë tok me gruan në punët shtëpiake, për t'ia lehtësuar asaj barrën e këtyre punëve që kanë rënduar vetëm mbi shpatullat e grave. Në vend të konceptit të vjetër ishte e nevojshme të rrënohej në mendjen e çdo burri, çdo djali, duke filluar nga mosha më e njomë, koncepti i ri, sipas të cilit punët e shtëpisë nuk janë vetëm për femrat por edhe për meshkujt, për gjithë pjesëtarët e familjes. (Së dyti) do të shfrytëzohej më mirë dhe të zgjerohej me ritëm më të shpejtë rrjeti i shërbimeve shoqërore. U shtuan kështu çerdhet e kopshtet për fëmijë

mbi parashikimet, u ngritën mensa, lavanderi etj., u zgjerua prodhimi e tregtimi i më shumë mjeteve që lehtësojnë punët shtëpiake, si edhe i artikujve të gatshëm ushqimorë.

Çlirimi i plotë i gruas varet në një shkallë të madhe nga zhvillimi i marrëdhënieve socialiste në familje.

Për krijimin dhe forcimin e familjes së re socialiste, sipas mësimëve të Partisë, u dendësua dhe u bë më konkrete lufta për çrrënjosjen e marrëdhënieve të vjetra në lidhjen e martesës dhe të jetesës bashkëshortore; për vendosjen e marrëdhënieve të reja martesore si edhe të marrëdhënieve të drejta midis burrit e gruas, midis gruas dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes, marrëdhënie të zhveshura nga ndjenja e pronës private, nga normat fetare, nga zakonet e pikëpamjet prapanike. Për të ndihmuar në forcimin e marrëdhënieve socialiste në familje u rishikuan disa norma të vjetra juridike që rregullonin marrëdhëniet familjare dhe u zëvendësuan me norma të reja, në përshatje me kushtet e etapës së re të zhvillimit të revolucionit socialist.

Çlirimi i plotë i gruas mbetet gjithnjë një nga detyrat më të rëndësishme të revolucionit socialist dhe nga frontet më të rëndësishme të luftës klasore. Lufta në këtë front nuk duhej të ngelej në asnjë mënyrë në mes të rrugës, ndryshe ngelej në mes të rrugës vetë revolucioni dhe ndërtimi socialist.

### **Lëvizja për revolucionarizimin e shkollës**

Karakterin e një lëvizjeje të gjerë popullore mori edhe lufta për zbatimin e

detyrës që vuri Kongresi V për revolucionarizimin e shkollës. Lëvizja përfshiu të gjitha anët e punës arsimore dhe edukuese.

① U ndërmorën aksione për të revolucionarizuar brendinë e mësimëve, për të ndryshuar ose për të përmirësuar programet e teksteve shkollore, për të përdorur metoda e forma të reja më revolucionare të mësimdhënies.

② Shpërthyen iniciativa për studimin në shkolla në mënyrë sistematike të dokumenteve të Partisë e të Veprave të shokut Enver Hoxha.

③ Rinia shkollore u ngrit e gjitha më këmbë në luftë kundër fesë dhe zakoneve prapanike jo vetëm brendapërbrenda shkollës, por edhe jashtë saj.

④ Rëndësi shumë të madhe kishin iniciativat për të lidhur shkollën me prodhimin. Një rol të veçantë luanin në këtë çë-

shtje aksionet kombëtare dhe lokale të rinisë në vepra të ndryshme ekonomike, në të cilat u përfshi gjithë rinia shkollore. Veç kësaj, filloi ngritja e bazave prodhuese (oficina, punishte, reparte) pranë shkollave, krahas vendosjes së lidhjeve me ndërmarrjet shtetërore e kooperativat bujqësore. U zgjerua edhe ndjekja e shkollave nga punëtorët e kooperativistët pa shpëputje nga puna.

U morën njëkohësisht masa për një lidhje më të shëndoshë të mësimit me kalitjen fizike dhe përgatitjen ushtarake, duke i kushtuar kësaj ane një kohë më të madhe dhe duke përdorur mënyra e forma të reja.

Një gjallëri të veçantë mori edhe veprimtaria jashtëshkollore e mësuesve dhe e nxënësve. Partia mbështeti iniciativat e arsimtarëve, që u përhapën në gjithë vendin, për një lidhje më të ngushtë të mësuesve me masat fshatare.

Lëvizja për revolucionarizimin e shkollës përshtohej nga fryma e kritikës revolucionare kundër normave e metodave të vjetruara, konservatore e reaksionare të pedagogjisë tradicionale borgjeze, si edhe kundër zyrtarizmit në marrëdhëniet midis mësuesve e nxënësve.

Revolucionarizimin e shkollës Partia e trajtonte si një pjesë përbërëse shumë të rëndësishme të revolucionit në fushën e ideologjisë e të kulturës, por edhe si armë për të çuar përpara revolucionin tekniko-shkencor.

Për shkollën Partia ka treguar gjithnjë një kujdes shumë të madh. Në periudhën e pushtetit popullor shkolla shqiptare ishte shndërruar në një djep diturie, kulture dhe edukimi revolucionar për masat e gjera të popullit, në një farkë përgatitjeje kuadrosh për të gjitha fushat e jetës së vendit.

Megjithatë, shkolla në Shqipëri nuk ishte çliruar krejt nga ndikimi i pedagogjisë dhe i shkollës borgjeze. Mësimi dhe edukimi ishin në përgjithësi të shpëputura nga jeta, nga prodhimi. Në metodat e mësimit kishte formalizëm e konservatorizëm. Në marrëdhëniet midis mësuesve e nxënësve kishte zyrtarizëm, ndrydhje të personalitetit të nxënësit. Këto ishin trashëgime nga shkolla e vjetër. Ka ndikuar në këtë edhe shkolla sovjetike. Përvoja e kësaj shkolle e kishte ndihmuar arsimin shqiptar, por doli se edhe kjo shkollë nuk qe çliruar krejt nga tiparet e pedagogjisë borgjeze, kishte, si rrjedhim, anët e saj negative.

Ndryshimet rrënjësore në bazën ekonomiko-shoqërore që kishin ndodhur në Shqipëri kërkonin medoemos që edhe shkolla, si pjesë përbërëse e superstrukturës, të pësonte shndërrime të atilla revolucionare që t'i përgjigjeshin më mirë asaj baze dhe qëllimit të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste.

Orientimet e Partisë për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës i dha shoku Enver Hoxha në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH, më 7 mars 1968. Këto orientime ishin një zberthim i mëtejshëm i ideve që kishte parashtruar në fjalën e mbajtur në gjimnazin «Qemal Stafa» të kryeqytetit në dhjetor 1965. Fjala në Byronë Politike «Mbi revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë» përbënte një program të madh pune. Ky program parashikonte:

① Shkolla, para së gjithash, të forcojë e të përsosë punën për formimin e njeriut të ri me botëkuptimin revolucionar marksist-leninist. Për këtë qëllim, studimi i marksizëm-leninizmit përmes lëndëve të materializmit dialektik e historik, të ekonomisë politike dhe historisë së Partisë të organizohet mbi baza më të shëndosha. Marksizëm-leninizmi të mësohet edhe nëpërmjet lëndëve të tjera, të cilat duhet të përshkohen fuqnd e krye nga filozofia marksiste-leniniste dhe nga politika proletare e Partisë.

② Kalitja revolucionare e nxënësve, brumosja e tyre me botëkuptimin marksist-leninist të sigurohet edhe me anë të lidhjes së ngushtë të mësimi me jetën, të shkollës me prodhimin, me punën për ndërtimin socialist e për mbrojtjen e atdheut, me anë të pjesëmarrjes së gjallë të pionierëve e të rinjve në punë të dobishme shoqërore, në jetën politike dhe ekonomike, në luftën klasore.

③ Lidhja e ngushtë e mësimi me punën prodhuese e me përgatitjen ushtarake e fizike, me jetën e vendit diktohet edhe nga nevoja për zgjidhjen e problemeve të mëdha ekonomiko-shoqërore e tekniko-shkencore, të zhvillimit të forcave prodhuese, të ndërtimit të plotë të bazës materialo-teknike të socializmit, si edhe të mbrojtjes.

Në përputhje me këto orientime, do të përsosej më tej gjithë sistemi arsimor.

Do të rishikoheshin e do të ripunoheshin programet e tekstit në të gjitha kategoritë e shkollave, duke ngritur nivelin e tyre shkencor dhe duke i zhveshur nga çdo gjë e tepërt dhe e panevojshme, nga frazeologjia e formulimet e ngatërruara,

veçanërisht nga çdo gjurmë e idealizmit. «Nuk duhet ta kuptojmë shkollën e re socialiste, — thoshte shoku Enver Hoxha, — me çfarëdolloj tekstesh, ku të bashkëjetojë botëkuptimi idealist-borgjez me atë marksist-leninist. Ne nuk duhet t'i bëjmë asnjë koncesion filozofisë idealiste borgjeze dhe as më të voglin koncesion teologjisë»<sup>1</sup>.

Do të revolucionarizoheshin më tej metodat e mësimdhënies e të edukimit, duke flakur metodat e vjetruara të pedagogjisë borgjeze: formalizmin, stereotipizmin e dogmatizmin, frazeologjinë boshe, që karakterizojnë atë pedagogji.

Kërkohej të bëhej një kthesë rrënjësore edhe në marrëdhëniet midis mësuesve e nxënësve duke luftuar për të zhdukur zyrtarizmin e tutelën burokratike në këto marrëdhënie, duke zhvilluar frymën e demokracisë revolucionare në shkollë, kuptimin revolucionar të disiplinës e të autoritetit të mësuesit, duke nxitur mendimin krijues të nxënësve e të studentëve.

Revolucionarizimi i shkollës kërkonte edhe arsimtarë revolucionarë, të brujtur me materializmin dialektik, me idetë e marksizëm-leninizmit, që të njohin e të zbatojnë me vendosmëri vijën politike të Partisë, që të bëjnë njëkohësisht përpjekje të pareshtura për zgjerimin e njohurive shkencore dhe për aftësimin e tyre profesional.

Partia e bëri revolucionarizimin e shkollës çështje të të gjithë Partisë, të pushtetit, të mbarë popullit. Ajo organizoi për këtë çështje një diskutim të madh popullor, që u zhvillua mbi bazën e tezave e të orientimeve që dha shoku Enver Hoxha dhe që zgjati afër një vit. Diskutimi u drejtua nga një komision i posaçëm i KQ të PPSH, të cilin e kryesonte shoku [REDAKTUAR] Rreth 600 000 vetë dhanë mendime, bënë vërejtje kritike dhe propozime të vlefshme gjatë diskutimit.

Analizën e këtyre mendimeve, vërejtjeve e propozimeve e bëri Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë që u mbledh në qershor të vitit 1969. Mbi bazën e kësaj analize dhe të tezave të shokut Enver Hoxha, ai mori vendime të rëndë-

---

<sup>1</sup> Enver Hoxha. Fjala e 7 marsit 1968. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 358.



sishme për revolucionarizimin e pandërprerë të shkollës shqiptare.<sup>1</sup>

Në thelb të këtyre vendimeve ishte orientimi kryesor i Partisë: «Të krijojmë një shkollë që t'u përgjigjet plotësisht detyrave të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste».

Në përputhje me këto vendime, u krye riorganizimi i shkollës në të gjitha shkallët e saj.

~~Arsimi 8-vjeçar u bë i detyrueshëm për gjithë zonat e vendit.~~

~~U zgjerua rrjeti i arsimit të ulët tekniko-profesional dyvjeçar për sigurimin e fuqisë punëtore të re të kualifikuar.~~

~~Arsimi i mesmë, me cikël 4-vjeçar, u zgjerua me një varg shkollash të reja të mesme të përgjithshme e profesionale të profileve të ndryshme. Ai u shtri në të gjitha rrethet, edhe në zonat malore.~~

~~Arsimi i lartë e përmirësoi strukturën e vet sipas pikësynimit për përgatitjen e specialistëve të lartë-të degëve të ndryshme. Periudha e studimeve në shkollat e larta u shkurtua përgjithësisht një vit. Studentët djem hynin në shkollën e lartë vetëm si të kishin bërë një vit punë prodhuese pas mbarimit të shkollës së mesme. Çdo student, pas ciklit të caktuar mësuesor, detyrohej të kryente një stazh 8-9 mujor në punë konkrete (sipas degës përkatëse), gjatë të cilit përgatitej për marrjen e diplomës.~~

Numri i nxënësve dhe i studentëve me shkëputje e pa shkëputje nga puna shënoi një rritje të madhe. Më 1970 ky numër ishte afër 30 për qind më i lartë se më 1965; punëtorë e kooperativistë që ndiqnin shkollën ishin 3 herë më shumë. Përveç shumë shkollave 8-vjeçare e të mesme, u ngritën në mjaft qytete e qendra industriale filiale të Universitetit të Tiranës.

Krahas shkollave, në sistemin e rregullt arsimor u përfshinë edhe shumë lloj kursesh me profile të ndryshme, të ngushta, për kualifikimin, riaftësimin e specializimin e punonjësve.

---

<sup>1</sup> Këto vendime përfshihen në raportin e Byrosë Politike të KQ të PPSH, mbajtur nga shoku Mehmet Shehu në Plenumin e KQ të PPSH, 26 qershor 1969. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. V, f. 552-629.

Riorganizimi i shkollës siguronte në radhë të parë një brendi ideologjike proletare më të shëndoshë të mësimit e të edukimit të nxënësve e të studentëve, një përvetësim më të thellë të teorisë marksiste-leniniste e të vijës politike revolucionare të Partisë.

Rëndësi të veçantë kishte ligjësimi që mori lidhja e mësimit me punën prodhuese dhe edukimin fizik e ushtarak. Kjo lidhje u bë më organike.

Një synim tjetër i shkollës së organizuar ishte t'u jepte nxënësve e studentëve një formim më të plotë arsimor e kulturor, shkencor e politeknik.

Në shkollë u bë një kthesë sidomos në lidhje me parimet e metodat e pedagogjisë revolucionare marksiste-leniniste, si edhe me normat e demokracisë socialiste, që gjetën një zbatim më të plotë e më të thellë.

U bë më i qartë gjithashtu koncepti revolucionar, sipas të cilit shkolla në socializëm nuk nxjerr drejtpërdrejt kadro drejtues e vetëm nëpunës, nuk jep diplomë për punë të privilegjuar intelektuale, por përgatit punëtorë e kooperativistë të arsimuar, specialistë revolucionarë, të aftë e të gatshëm për t'i shërbyer me besnikëri popullit e socializmit, ku të ketë nevojë atdheu.

Si të gjithë sektorët e jetës së vendit, edhe shkolla u vu nën një kontroll të drejtpërdrejtë më sistematik të masave të gjera punonjëse, sidomos të klasës punëtore e të fshatarësisë kooperativiste.

Procesi i revolucionarizimit të shkollës nuk zhvillohej pa pengesa e pa vështirësi. Partisë e pushtetit iu desh të zhvillonin një luftë të ashpër kundër mentaliteteve, shpërhive, metodave dhe praktikave të vjetra regresive, të zgjidhnin me përpjekje të shumta mjaft probleme të karakterit material e financiar, por edhe të karakterit ideologjik-shoqëror, për të plotësuar vendimet e Plenumit të Komitetit Qendror për shkollën. Është dashur të luftohet e të asgjësohet edhe ndonjë orvatje e armikut të klasës për të penguar lëvizjen e revolucionarizimit të shkollës.

Partia ishte e ndërgegjeshme se revolucionarizimi i shkollës nuk merrte fund me një lëvizje. Ai do të ishte një proces i vazhdueshëm, që do të ecte përpara, si çdo proces tjetër, nëpërmjet një lufte të ashpër klasore dhe nëpërmjet një pune të madhe krijuese të shumanshme.

## **Për revolucionarizimin e letërsisë dhe të arteve**

Lufta për revolucionarizimin e jetës së vendit përfshiu edhe fushën e letërsisë dhe të arteve, që përbën «një nga fushat e rëndësishme të veprimtarisë ideologjike të Partisë»<sup>1</sup>.

Kjo fushë ka qenë gjithnjë në qendër të vëmendjes së Partisë e të pushtetit popullor. Si rrjedhim i këtij kujdesi, artet dhe letërsia e re shqiptare, të krijuara gjatë viteve të diktaturës së proletariatit, ecnin përpara me hapa të sigurt në rrugën e drejtë të realizmit socialist. Pas orientimeve që dha Plenumi i posaçëm i Komitetit Qendror të Partisë për artet e letërsinë, në tetor 1965, krijimtaria në këtë fushë kishte marrë një hov të ri, qe pasuruar me vepra të reja — edhe të një cilësie më të lartë artistike, edhe të një përmbajtjeje më të shëndoshë ideologjike, kishte fituar një karakter më luftarak e një forcë më të madhe edukuese.

Mirëpo borgjezia me revizionizmin modern zhvillonin një luftë të egër kundër metodës shkencore të realizmit socialist, kurse në vendet kapitaliste e borgjezo-revizioniste kishin marrë një përhapje shumë të gjerë rrymat moderniste në letërsi dhe arte. Letërsia dhe artet në Shqipëri nuk ishin të imunizuara nga ndikimet që mund të ushtronin mbi to këto rryma. Kongresi V i Partisë kishte kritikuar institucionet kulturore dhe artistike, Lidhjen e Shkrimtarëve, Ndërmarrjen e Botimeve dhe organet e shtypit letrar, organizatat-bazë e kuadrot drejtues të këtyre institucioneve, që nuk tregonin vigjilencën e duhur dhe kishin lejuar punime letrare e artistike, përmbajtja e të cilave nuk pajtohej me ideologjinë proletare, që nuk zhvillonin një luftë të vazhdueshme për zbatimin e orientimeve të Partisë në fushën e letërsisë e arteve. Ai kishte shtruar detyrën të fuqizohej lufta për zhvillimin e një letërsie dhe arti të realizmit socialist, të sigurohej një revolucionarizim i shpejtë i botimeve letrare, i gjithë krijimtarisë letrare e artistike.

Partia me institucionet kulturore e artistike morën një varg masash për zbatimin e kësaj direktive. Veprat letrare e artistike me përmbajtje të dobët e të papërshtatshme iu nën-

---

1 Enver Hoxha. Fjala në Konferencën e 17-të të Partisë për Tiranën, 21 dhjetor 1968. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 478.

shtruan një kritikë të gjithanshme. Lufta u drejtua si kundër koncepteve liberale e moderniste borgjeze e revizioniste, ashtu edhe kundër koncepteve konservatore. U godit veçanërisht e ashtuquajtura «teori e distancës», sipas së cilës letërsia dhe artet s'mund t'i përgjigjen flakë për flakë pasqyrimit të realitetit pa cenuar nivelin e tyre artistik. Kjo teori borgjeze e shkëput shkrimtarin dhe artistin nga realiteti, nga jeta dhe nga veprimtaria e gjallë e masave.

Komiteti Qendror i Partisë ndiqte nga afër luftën për revolucionarizimin e letërsisë dhe të arteve. Udhëheqja e Partisë, për t'i dhënë shtytje më të vullshme kësaj lufte, iu kthye përsëri në dhjetor 1968 problemeve të mprehta e delikate të krijimtarisë letrare e artistike, duke kërkuar që kjo krijimtari të ecte medoemos me hapin e masave popullore, me hapin e klasës punëtore, Moton e Partisë, që duhet të udhëheqë gjithë letërsinë e artet, shoku Enver Hoxha e përkufizonte me këto fjalë: «Çdo gjë për popullin, çdo gjë që krijohet të mbajë vulën e krijimtarisë popullore, të shpirtit revolucionar popullor, të realizmit socialist. Jashtë këtyre asgjë nuk vlen».<sup>1</sup>

Duke iu përgjigjur këtij orientimi-bazë të Partisë, shumë shkrimtarë dhe artistë shkuan për të jetuar e për të punuar në qendra industriale, në kantiere ndërtimi e në kooperativa bujqësore. Jeta pranë punëtorëve e fshatarëve, pjesëmarrja tok me ta në punë prodhuese, i ndihmuan ata të njihnin më mirë heroizmin e masave, shpirtin dhe forcën e tyre krijuese, përparimet vigane, problemet e mprehta, gjithë të mirat e të metat, pengesat e vështirësitë në punën për ndërtimin socialist. Kjo u shërbeu atyre për një krijimtari më të bollshme, më realiste, më revolucionare, më luftarake, si asnjëherë më parë.

Një zhvillim të mëtejshëm mori në këtë kohë edhe lëvizja amatore artistike në ndërmarrje e kooperativa bujqësore. Kjo e ngriti në një shkallë më të lartë rolin e masave në krijimin e artit të ri.

Lëvizja për revolucionarizimin e letërsisë dhe arteve solli thellimin e luftës së klasave në këtë fushë. Revolucionarizimi

---

1 Enver Hoxha. Fjala në Konferencën e 17-të të Partisë për Tiranën. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 487.

i veprimtarisë letrare e artistike ua prishte planin elementëve të maskuar armiq, që shpresonin dhe orvateshin të godisnin vijën e Partisë, rendin socialist nëpërmjet ndikimeve borgjeze e revizioniste në frontin e kulturës, në letërsi dhe arte. Fjala e shokut Enver Hoxha në dhjetor 1968, që u jepte një goditje dërrmuese shfaqjeve të huaja në letërsi dhe arte, i stepi ata, i detyroi të bënin një tërheqje, të ndërronin ndonjë taktikë për t'u dukur si përkrahës të revolucionarizimit. Në të vërtetë ata nuk e ndërprejnë veprimtarinë e tyre minuese, veçse u munduan të bënin më shumë zhurmë për të krijuar përshtypjen sikur zbatonin direktivat e Partisë «në mënyrë krijuese».

Por armiqtë s'kishin bazë e forca të atilla që të mund të ndalnin procesin e revolucionarizimit të letërsisë e arteve në Shqipëri. Rrjedha e luftës së ashpër klasore dhe politika revolucionare që ndiqte PPSH në këtë luftë do të zbulonin krejt fytyrën e tyre, kalbësinë e pikëpamjeve të tyre borgjeze e revizioniste, të cilat Partia me masat punonjëse do t'i shkullnin nga rrënjët.

#### 4. REVOLUCIONARIZIMI NË FUSHËN E EKONOMISË

Revolucionarizimi në fushën ekonomike u përqendrua kryesisht në thellimin e revolucionit tekniko-shkencor, në përsosjen e drejtimit të ekonomisë dhe në plotësimin e detyrave të planit të 4-t pesëvjeçar.

##### **Thellimi i revolucionit tekniko-shkencor**

Plenumi i Komitetit Qendror i torit 1967 arrinte në konkluzionin se nuk mund të plotësoheshin kërkesat e ndërtimit të plotë të bazës materialo-teknike të socializmit, pa zhvilluar më tej revolucionin tekniko-shkencor, si pjesë përbërëse e revolucionit socialist.

Zhvillimi i ekonomisë socialiste në Shqipëri i kishte hapur vendit perspektiva të reja. Por ç'duhet të bëjmë që të realizohen këto perspektiva? — shtronte pyetjen shoku Enver Hoxha në Plenum. «T'i futemi me forca të shumëfishuara revolucionit tekniko-shkencor jo vetëm në industri, por edhe në bujqësi e në të gjithë sektorët e tjerë. Në të gjitha drejtimet ne

duhet të kapërcejmë nga faza artizanale në teknikë të përparuar, në agroteknikë moderne. Ne mund të themi se i kemi bazat e nevojshme për ta thelluar revolucionin tekniko-shkencor»<sup>1</sup>.

Ky revolucion do të zhdukte praktikat dhe mentalitetet artizanale të prodhimit, të çrrënjoste te punonjësit ndjenjën e inferioritetit në lidhje me teknikën, që kishte pasur qenë e theksuar në ndërgjegjen e tyre, të formuar në kushtet e prapambetjes së dikurshme. Ai do të siguronte një përhapje sa më të gjerë, një zbatim e përvetësim sa më të thellë të teknikës moderne e të njohurive shkencore në prodhim.

Si hallkë kryesore e revolucionit tekniko-shkencor në këtë kohë u kap çështja e mekanizimit.

Zhvillimi i industrisë mekanike do të zgjidhte shumë probleme tekniko-ekonomike, do të plotësonte shumë nevoja për prodhimin në vend të pjesëve të ndërrimit, të pajisjeve e makinerive për minierat, për naftën, për bujqësinë, për ndërtime etj.

Partia kërkonte, nga njëra anë, të shfrytëzoheshin plotësisht të gjitha aftësitë prodhuese të industrisë mekanike ekzistuese, nga ana tjetër, të zhvillohej më tej kjo industri, duke zgjidhur një varg problemesh të përqendrimit, të specializimit e të kooperimit të saj.

Thellimi i revolucionit tekniko-shkencor shtronte edhe një varg çështjesh të tjera, të lidhura me zhvillimin e ekonomisë popullore. Ai kërkonte një mobilizim më të madh e një organizim më të mirë të studimit të teorisë e të ligjeve të shkencës; kërkonte zbatimin e një disipline të rreptë shkencore, një përgatitje e kualifikim më sistematik e mbi baza më të shëndosha të kuadrove, të specialistëve e të punonjësve të të gjithë sektorëve, përpjekje më këmbëngulëse të tyre për të zotëruar teknologjinë e përparuar.

Midis të tjerave, shoku Enver Hoxha tërhiqte vëmendjen edhe për një kuptim të drejtë të revolucionit tekniko-shkencor në kushtet e socializmit. «Do të jetë gabim, — thoshte ai,

---

<sup>1</sup> Enver Hoxha. Fjala e mbajtur në Plenumin III të KQ të PPSH, 14 tetor 1967. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 250.

— të mendohet që revolucionin tekniko-shkencor do ta bëjnë vetëm disa njerëz të mësuar... Jo, si çdo revolucion të vërtetë, edhe revolucionin tekniko-shkencor do ta bëjnë masat e gjera... të punonjësve...»<sup>1</sup>. Prandaj Partia vinte detyrë që zotërimi i teknikës, kualifikimi dhe specializimi, eksperimentimi shkencor, novacionet, shpikjet dhe racionalizimet të bëheshin çështje e kolektivave të gjera, pasuri e masave. Për këtë ajo kërkonte të realizohej një unitet i plotë në punë midis punëtorëve, inxhinierëve e teknikëve, midis kooperativistëve dhe agronomëve. Shtylla e revolucionit teknik duhej të bëhej brezi i ri, ndaj të cilit Partia dhe shteti socialist tregonin një kujdes të madh, për ngritjen e tij në një nivel të lartë ideopolitik, arsimor, teknik.

Direktivat e Partisë për revolucionin tekniko-shkencor i dhanë këtij revolucion një hov të ri. Në zbatim të këtyre direktivave, shpërthyen iniciativa të masave punonjëse në fushat e prodhimit, të edukimit, të organizimit e drejtimit. Mori një zhvillim të ri lëvizja për shpikje e racionalizime. U ndërtua mbi baza më të shëndosha puna kërkimore shkencore dhe eksperimentimi shkencor.

Partia, që udhëhiqte këtë revolucion, për ta thelluar e zgjeruar vazhdimisht, kujdesej në të njëjtën kohë që ai të zhvillohej gjithnjë në rrugë të drejtë. Ideologët borgjezë e revizionistë e paraqesin revolucionin tekniko-shkencor si barin që do të shërojë të gjitha plagët, që do të zhdukë të gjitha të këqijat e kapitalizmit, që do të eliminojë antagonizmat dhe do të shuajë luftën klasore, që do ta shndërrojë shoqërinë kapitaliste në një shoqëri socialiste! Shoku Enver Hoxha, duke flakur tej këto pretendime absurde të borgjezisë e të revizionizmit modern, theksonte se, pavarësisht nga roli i madh që luan revolucionin tekniko-shkencor, «ai që do ta shkatërrojë pushtetin e borgjezisë kapitaliste dhe të revizionistëve modernë, për të vendosur socializmin është dhe mbetet revolucionin proletar dhe jo revolucionin tekniko-shkencor»<sup>2</sup>.

---

1 Enver Hoxha. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 255.

2 Enver Hoxha. Fjala në Konferencën e 18-të të Partisë të Rrethit të Tiranës. Raporte e fjalime 1970-1971, f. 442.

**Revolucionarizimi i mëtejshëm i drejtimit të ekonomisë** — Detyrat e mëdha, aktuale — e perspektive, të zhvillimit ekonomik dhe thellimi i revolucionit tekniko-shkencor shtrojnë nevojën e përsosjes së drejtimit të ekonomisë.

Përsosja e drejtimit të ekonomisë diktohej edhe nga përfundimi plotësisht i kolektivizimit të bujqësisë më 1967 dhe nga zmadhimi i mëtejshëm i kooperativave bujqësore nëpërmjet bashkimit të tyre në njësi të mëdha ekonomike.

Por përsosjen e mëtejshme të drejtimit të ekonomisë në përgjithësi e pengonte rutina praktikiste, centralizmi i tepëruar. Këto dobësi e të meta, siç vuri në dukje Plenumi i KQ të PPSH në qershor 1970, e kishin burimin në karakterin e theksuar mikroborgjez dhe në prapambetjen kulturore të vendit në të kaluarën, në mungesën e traditave të një organizimi të përparuar e shkencor në punë. Ato rridhnin edhe nga shtrembërimet burokratike në veprimtarinë e organeve shtetërore dhe ekonomike, në punën e Partisë e të organizatave të masave.

Duke analizuar rrethanat konkrete, Komiteti Qendror vendosi të merreshin masa revolucionarizuese edhe në fushën e drejtimit të ekonomisë.

Pa prekur parimin e drejtimit të centralizuar të ekonomisë, ndërmarrjeve ekonomike dhe kooperativave bujqësore iu dhanë më shumë kompetenca. «Shtimi i të drejtave dhe i kompetencave të ndërmarrjeve, — thoshte shoku Enver Hoxha, — duhet parë si një masë shumë e rëndësishme, që ka për qëllim të arrihen rezultate sa më të mëdha në zhvillimin e shpejtë të prodhimit dhe të forcohet demokracia socialiste në rrugë marksiste-leniniste. E gjithë kjo synon që te punëtorët të rrenjosej sa më thellë ndjenja, psikologjia, bindja se ai është zot i ndërmarrjes, se ai e drejton vetë ndërmarrjen, se fati i ndërmarrjes dhe i prodhimit për të shkuar përpara janë në dorë të vetë punëtorëve».<sup>1</sup>

Për të përsosur drejtimin shkencor revolucionar të ekonomisë u bënë shumë përpjekje që të zbatoheshin orien-

---

<sup>1</sup> Enver Hoxha. Fjala në Byronë Politike, 7 dhjetor 1970. Raporte e fjalime 1970-1971, f. 133-134.



timet e Kongresit V për të përdorur drejt e me këmbëngulje kategoritë e levat ekonomike për rritjen e rendimentit, për uljen e kostos, për shtimin e përdorimin në mënyrë sa më efektive të akumulimit, për kursimin e fondeve themelore e të xhiros, për shfrytëzimin e të gjitha aftësive prodhuese, për rritjen e rentabilitetit në punën e ndërmarrjeve.

Një rol vendimtar në përsosjen dhe revolucionarizimin e ekonomisë, në thellimin e revolucionit tekniko-shkencor luajti forcimi i organizimit të punës.

Bazë për këtë shërbyen udhëzimet e Plenumit të KQ të PPSH, në qershor 1970, mbi kuptimin teorik e praktik të organizimit të punës. Plenumi shpjegonte se organizimi është bazë dhe pjesë përbërëse e zbatimit të direktivës, të detyrës, të ligjit. Është mjet i fuqishëm që çon përpara zhvillimin, punën, mendimin. Organizimi i përsosur kërkon dituri, vullnet të fortë e punë të palodhur. Ai është një art që mbështetet në njohuritë e gjera shkencore, politike, ekonomike, teorike. «Pa organizuar punën në përshtatje me kërkesat e ligjeve objektive, — mësonte shoku Enver Hoxha, — ekzistojnë rreziqe serioze që shpien në dështime të mëdha»<sup>1</sup>.

Për revolucionarizimin e drejtimit të ekonomisë ndikoi drejtpërdrejt forcimi i punës udhëheqëse dhe organizuese të Partisë në ekonomi.

### **Plotësimi i planit të 4-t pesëvjeçar**

Frytet e politikës ekonomike të Partisë, të punës së madhe të saj e të masave punonjëse për revolucionarizimin e ekonomisë u dukën në plotësimin e detyrave të planit të 4-t pesëvjeçar.

Me gjithë rrethimin e bllokadën imperialisto-revizioniste, plani i prodhimit të përgjithshëm industrial u plotësua para afatit, në katër vjet e shtatë muaj. Rritja mesatare vjetore e tij përbënte 12,9 për qind kundrejt 8,7 për qind që parashikonin direktivat e Kongresit V. Rritje më të larta u shënuan në industrinë kimike, industrinë mekanike, industrinë elektrike, industrinë e materialeve të ndërtimit, që dhanë përkatë-

---

<sup>1</sup> Enver Hoxha. Raporte e fjalime, 1969-1970, f. 377.

sisht brenda pesë vjetëve një prodhim 7 herë, 3,2 herë, 2,8 herë dhe 2,6 herë më të madh.

Gjatë pesëvjeçarit u ndërtuan 200 vepra të mëdha të rëndësishme për ekonominë e kulturën popullore.

Një rritje të dukshme shënoi edhe prodhimi bujqësor. Në pesëvjeçarin e katërt bujqësia mori 6 herë më shumë plehra kimike, kurse shkalla e mekanizimit të punimeve bujqësore u rrit 80 për qind.

Të ardhurat kombëtare u tejkaluan. Ndërkaq u realizuan edhe parashikimet për ngritjen e mirëqenies së popullsisë. Nuk pati asnjë ngritje çmimesh, asnjë grimë inflacioni, në një kohë kur në vendet kapitaliste e revizioniste në këtë periudhë të tilla dukuri qenë bërë një sëmundje kronike dhe paralajmëronin një shpërthim në përmasa të gjera e të thella të krizës ekonomike në botën kapitalisto-revizioniste.

Dy fitore të mëdha me karakter ekonomik e shoqëror përbënin: elektrifikimi i të gjitha fshatrave të vendit, që u plotësua në tetor 1970, 13 muaj përpara afatit të caktuar në vendimin e Plenumit të KQ të Partisë të dhjetorit 1967; heqja kreytësisht e sistemit të taksave me vendim të Komitetit Qendror të Partisë e të Këshillit të Ministrave, në nëntor 1968. **Kështu Shqipëria socialiste, dikur vendi më i prapambetur në Evropë, u bë një ndër vendet e pakta në botë me fshatra plotësisht të elektrifikuar dhe vendi i parë pa taksa.**

Komiteti Qendror i Partisë dhe Qeveria morën edhe një varg masash të tjera në dobi të rritjes së mirëqenies materiale të popullit, si ulja e çmimeve të disa mallrave të përdorimit të gjerë, të barërave mjekësore, të insekticideve e të disa makinerive bujqësore, të disa lloj shërbimeve; heqja e tatimit vjetor mbi të ardhurat në kooperativat bujqësore të zonave malore e kodrinore; falja e kredive të dhëna nga shteti dhe ulja e tarifave të SMT-ve për punimet e tyre në këto zona etj.

Pesëvjeçari i katërt, ka thënë shoku Enver Hoxha, «do të hyjë në histori si periudha e iniciativave të mëdha popullore dhe e heroizmit masiv, kur forca e bashkuar e popullit, nën udhëheqjen e Partisë, bëri të tunden malet e fushat»<sup>1</sup>.

---

1 Enver Hoxha. Raport në Kongresin VI të PPSH. Kongresi VI i PPSH, 1972, f. 70.

## 5. KARAKTERI REVOLUCIONAR, KONSEKUENT I POLITIKËS SË JASHTME TË PARTISË

PPSH ndiqte vazhdimisht me një vëmendje shumë të madhe zhvillimin e gjendjes ndërkombëtare. Kjo ndjekje nuk ishte seditëse, por vepruese, për të jetuar aktivisht me situatat e jashtme.

Të jetuarit me këto situata për Partinë dhe popullin shqiptar ka qenë gjithnjë një çështje jetësore për fatet e revolucionit e të socializmit në Shqipëri. Qëllimi i Partisë është që t'i kuptojë ato sa më thellë e t'i vlerësojë drejt, të mbajë qëndrime revolucionare marksiste-leniniste për njërën ose tjetrën ngjarje dhe për gjendjen ndërkombëtare në përgjithësi, të përcaktojë pa u gabuar miqtë dhe armiqtë, t'u dalë përpara rreziqeve që i vijnë nga jashtë pavarësisë kombëtare dhe socializmit, të sigurojë mbështetjen e forcave revolucionare, përparimtare e liridashëse botërore, të dijë si të zbatojë, në përshtatje me situatat, të gjitha detyrat e brendshme të ndërtimit socialist e të mbrojtjes së atdheut dhe të kontribuojë në çështjen e përbashkët të çlirimit kombëtar e shoqëror të popujve.

Partia e Punës e Shqipërisë, duke zbatuar direktivat e Kongresit V, vazhdonte të ndiqte një politikë të jashtme parimore konsekuente në të gjitha drejtimet e për të gjitha problemet.

Kjo politikë pasqyrohet në qëndrimet e saj revolucionare për problemet e ngjarjet e mëdha ndërkombëtare dhe në marrëdhëniet e Shqipërisë socialiste me vendet e tjera.

### **Qëndrimet revolucionare të PPSH ndaj problemeve e ngjarjeve ndërkombëtare**

Një nga problemet e mëdha të kësaj kohe ishte çështja kineze.

PPSH i erdhi në ndihmë popullit kinez në atë periudhë shumë kritike që po kalonte Kina, si pasojë e tronditjeve të thella të brendshme dhe e sulmeve të egra, që drejtonte kundër saj fronti i bashkuar imperialisto-revizionist. Duke kujtuar se Kina ishte një vend socialist dhe PK e Kinës një parti marksiste-leniniste, PPSH tregojë kurdoherë solidarë me to dhe luftonte për forcimin gjithnjë e më shumë të miqësisë e të aleancës luftarake midis dy partive e të dy vendeve mbi bazën e marksizëm-leninizmit e të internacionalizmit proletar, pavarësisht nga kundërshtimet

që kishte për një varg pikëpamjesh e veprimesh jomarksiste të udhëheqjes kineze.

Nga këto pozita PPSH mbështeti Revolucionin Kulturor në Kinë. Por ajo mbështeti qëllimin kryesor që mendohej se mund të arrihej për likuidimin e elementëve kapitalistë e revizionistë dhe jo çdo taktikë e çdo metodë që u përdorën në atë revolucion-rrëmujë, i cili, siç tregoi rrjedha e ngjarjeve, «nuk ishte as revolucion, as i madh, as kulturor dhe sidomos aspak proletar»<sup>1</sup>. PPSH nuk mund të pajtohej me karakterin anarkist të veprimeve gjatë Revolucionit Kulturor Kinez, me mungesën e udhëheqjes së klasës punëtore e të Partisë Komuniste në të. Ajo mbronte çështjen e socializmit në Kinë, mbronte popullin kinez dhe Partinë Komuniste të Kinës, por s'mbronte aspak luftën fraksioniste midis vijave e rrymave të kundërta, që përlesheshin midis tyre, deri edhe me armë, jo për të shpëtuar ose për të vendosur diktaturën e proletariatit e socializmin, por për të zënë pushtetin secila për llogari të vet.

Përpjekje të vazhdueshme e të shumanshme kishte zhvilluar e zhvillonte PPSH për mbrojtjen e Kinës në arenën ndërkombëtare.

Shqipëria socialiste kishte bërë një luftë të gjatë e këmbëngulëse diplomatike për rivendosjen e të drejtave të RP të Kinës në OKB, që i mohoheshin nga imperialistët amerikanë me aleatët e tyre, tërthorazi edhe nga revizionistët sovjetikë. Më në fund, në tetor 1971, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së e pranoi rezolutën shqiptare, të paraqitur bashkërisht me një numër vendesh të tjera, dhe RP e Kinës zuri vendin e vet në këtë organizatë ndërkombëtare.

Ndërkohë, PPSH kishte pikëpamje të kundërta me udhëheqësit kinezë për mjaft çështje të politikës së tyre të jashtme. Duke gjykuar nga interesat e revolucionit e të socializmit në shkallë botërore, disa herë ajo u kishte shfaqur atyre, në mënyrë shoqërore, dëshirën që Kina të vepronte më gjallërisht dhe më me iniciativë në mbrojtje të interesave të popujve, në mbështetje të lëvizjes revolucionare e luftërave çlirimtare. Kjo do të ishte edhe në interes të vetë Kinës. Mirëpo udhëheqësit kinezë zbatonin një politikë të interesave të ngushta nacionale, që e kishte veçuar atë nga popujt liridashës e nga bota.

1 Enver Hoxha. Imperializmi dhe revolucioni, f. 384.

PPSH dhe populli shqiptar vazhdonin t'i jepnin luftës çlirimtare të popullit vietnamez kundër agresionit imperialist amerikan gjithë përkrahjen e ndihmën e mundshme.

Agresorët amerikanë, duke parë se nuk e mposhtnin dot popullin vietnamez në fushën e betejës, përdorën lloj-lloj dredhish për t'ia arritur pikësynimit me rrugë të tjera. Më në fund zgjodhën rrugën e imponimit të vullnetit të tyre me anë të «bisedimeve paqësore», të vetmen që u kishte ngelur, duke pasur për këtë ndihmën e revizionistëve sovjetikë. PPSH e quante të padobishme e shumë të rrezikshme rrugën e bisedimeve. Ajo qëndronte gjithnjë e vendosur në pikëpamjen e saj se populli vietnamez do të fitonte me siguri, por këtë fitore do ta arrinte vetëm me anë të armëve.

Më 1970, kur imperialistët amerikanë ndërморën një agresion të armatosur kundër popullit kamboxhian, PPSH mbajti menjëherë një qëndrim të vendosur duke marrë krahun e popullit kamboxhian në luftën kundër këtij agresioni dhe kundër reaksionit të brendshëm.

Gjithashtu ajo dënoi pa ngurrim agresionin që kreu ushtria izraelite me ndihmën e drejtpërdrejtë të SHBA, në qershor 1967, kundër Egjiptit, Sirisë e Jordanisë dhe demaskoi gjithë brendinë e këtij agresioni si një komplot i madh ndër-imperialist kundër lirisë, pavarësisë dhe interesave ekonomike të popujve arabë. Në prapaskenë të komplotit s'ishin vetëm imperialistët amerikanë, por edhe sovjetikë. Sikush nga këta imperialistë, të cilët dolën menjëherë në rolin e arbitrit, kërkonin të zinin pozita ushtarake dhe ekonomike në Lindjen e Mesme, që përbën një nyje shumë të rëndësishme strategjike dhe një zonë shumë të pasur nafte.

Duke mbështetur çështjen e drejtë arabe në përgjithësi dhe çështjen palestineze në veçanti, PPSH shprehte pikëpamjen se popujt arabë nuk mund t'u zinin besë as sovjetikëve as amerikanëve, sepse të dy palët janë armiq të tyre. S'mund të kishte zgjidhje paqësore të këtyre çështjeve. Vetëm duke u bashkuar në luftën e armatosur çlirimtare kundër sionistëve dhe imperialistëve, pa lejuar asnjë ndërhyrje të jashtme, popujt arabë do të mund të mbronin nderin e të fitonin të drejtat e ligjshme të tyre.

Qëndrime të tilla të vendosura parimore, revolucionare mbante PPSH edhe për ngjarjet e çështjet e tjera ndërkombëtare.

Ajo kundërshtonte me këmbëngulje manovrat e imperialistëve amerikanë e të revizionistëve sovjetikë për problemin e çarmatimit. Zhurma që bënin ata rreth këtij problemi kishte vetëm qëllim të vinte në gjumë popujt. Në një kohë kur flisnin kaq shumë për «dëshirat» dhe «përpjekjet» e tyre për çarmatim, duke krijuar komitete e komisione të panumërta, ata ndiqnin garën e shfrenuar të armatimit e të zhvillimit të armëve të shfarosjes në masë, të zgjerimit e të forcimit të bazave e të flotave detare ushtarake. Në mënyrë të veçantë PPSH demaskoi të ashtuquajturin «Traktat mbi mospërhapjen e armëve bërthamore», të nënshkruar në Uashington, në Moskë e në Londër në mars 1970, duke e cilësuar atë një komplot të madh imperialisto-revizionist, një orvajtje të re për të mashtruar popujt, një marrëveshje që nuk përbënte aspak një «hap drejt çarmatimit» siç e shpallnin autorët e tij, por një hap të ri në garën midis superfuqive për shtimin e përsosjen e këtyre armëve, rrjedhimisht një rritje të rrezikut kundër paqes e sigurisë së popujve.

PPSH demaskonte blonin imperialisto-revizionist mbi sigurimin evropian. Populli shqiptar, si të gjithë popujt e tjerë të Evropës, kishte dëshirë të zjarrtë për paqe e siguri në kontinent e në gjithë botën. Por këto s'mund t'ia jepnin Evropës revizionistët sovjetikë dhe imperialistët amerikanë, që e kishin mbytur atë me ushtri, me flota e baza ushtarake si edhe me kapitalet e tyre skllavëruese. «Sigurimi evropian» që kërkonin Bashkimi Sovjetik revizionist dhe disa vende të Evropës Perëndimore, prapa të cilave qëndronin SHBA, në vend të sigurisë, e shtonte edhe më shumë pasigurinë, përjetësonte statukuonë e sundimit sovjeto-amerikan në Evropë dhe e rëndonte më shumë shfrytëzimin imperialisto-revizionist mbi popujt evropianë.

PPSH e demaskoi qëllimin e vërtetë të Traktatit sovjeto-gjermanoperëndimor, që u nënshkrua në gusht të vitit 1970. Ky traktat nuk kishte aspak qëllime paqësore, siç pretendonin revizionistët sovjetikë. Përkundrazi, të dy palët kishin pikësynime hegjemoniste në Evropë. Kjo marrëveshje përfundohej pa i pyetur fare popujt që kishin luftuar e kishin derdhur gjak kundër nazizmit gjerman.

PPSH ndiqte me vëmendjen më të madhe zhvillimin e gjendjes në vendet ish-socialiste, ku qe rivendosur tashmë plotësisht kapitalizmi me pasojat e tij të shtypjes e të shfrytëzimit

të punonjësve, të inflacionit, të ngritjes së çmimeve, të krizave ekonomike, politike e shpirtërore, të mënyrës borgjeze të jetesës, të politikës së jashtme nacionaliste. Në këto vende, duke përfshirë edhe Bashkimin Sovjetik, ndodhnin vazhdimisht trazira, greva, protesta, revolta si rrjedhim i pakënaqësisë së masave popullore. Në Poloni në vitin 1970 punëtorët e një numri qytetesh u hodhën në grevë të përgjithshme dhe u përleshën në rrugë e në fabrika me policinë. Kjo ngjarje u bë shkak për rrëzimin e klikës tradhtare të Gomulkës, por nuk solli e nuk mund të sillte asnjë përmbysje revolucionare të gjendjes. Klasa punëtore dhe masat e gjera punonjëse, të çarmatosura, pa unitet, pa përgatitjen ideologjike e politike të nevojshme, pa udhëheqje revolucionare ishin të paafta për veprime rrënjësore. Në këto kushte, gjykonte PPSH, «klasa punëtore e vendeve revizioniste ndodhet tani përpara domosdoshmërisë historike që të zbresë përsëri në fushën e betejës, të hidhet në një luftë të pamëshirshme e gjer në fund konsekuente për përmbysjen e shpartallimin e klikave tradhtare, për të kryer edhe një herë revolucion proletar, për të rivendosur diktaturën e proletariatit»<sup>1</sup>.

## **Denoncimi i Traktatit të Varshavës**

Qëndrimi revolucionar parimor i PPSH në çështjet ndërkombëtare u duk në mënyrë të veçantë me rastin e agresionit ushtarak që kryen revizionistët sovjetikë, në gusht 1968, kundër Çekoslovakisë.

Në këtë agresion, veç ushtrisë sovjetike, morën pjesë edhe ushtritë e Polonisë, të Gjermanisë Lindore, të Bullgarisë e të Hungarisë. Këto ushtri pushtuan gjithë territorin çekoslovak, rrëzuan klikën e Dubčekut, e cila kapitulloi në mënyrë të turpshme pa asnjë qëndresë, dhe vendosën një klikë tjetër tradhtare, shërbëtore të plotë të imperializmit sovjetik. Populli çekoslovak, i tradhtuar dhe i ngelur pa asnjë udhëheqje, bëri vetëm një qëndresë pasive.

PPSH e dënoi me vendosmëri këtë akt barbar duke e cilësuar atë një «agresion të tipit fashist», që «përfaqëson

---

<sup>1</sup> Artikulli i «Zërit të popullit» shkruar nga shoku Enver Hoxha «Klasa punëtore në vendet revizioniste duhet të zbresë në fushën e betejës e të rivendosë diktaturën e proletariatit», 24 mars 1966.

poshtërimin më të madh që u ka bërë klika revizioniste hrushoviane e Brezhnjev-Kosiginin nderit dhe prestigjijt të Bashkimit Sovjetik e të popullit sovjetik», «paralajmërimin më të madh për popullin sovjetik, për popujt e vendeve socialiste dhe të vendeve që sundohen nga klikat revizioniste, për popujt e Evropës dhe të të gjithë botës mbi rrezikshmërinë e klikës revizioniste kundërrevolucionare që sundon sot në Bashkimin Sovjetik, mbi qëllimet dhe metodat e saj imperialiste dhe fashiste për sundimin e popujve»<sup>1</sup>. Në ato çaste të rënda që kalonte populli çekoslovak, PPSH i shprehu atij solidaritetin dhe përkrahjen internacionaliste më të vendosur të popullit shqiptar, duke i kujtuar se «e vetmja rrugë shpëtimi dhe për të rifituar lirinë. . . është rruga e luftës pa kompromis dhe deri në fund kundër pushtuesve të huaj, revizionistëve sovjetikë, gjermanë, polakë, hungarezë dhe bullgarë, lufta kundër imperializmit amerikan dhe revanshizmit gjerman, lufta kundër gjithë revizionistëve dhe reaksionarëve të vendit»<sup>2</sup>. Në të njëjtën kohë ajo u bënte thirrje gjithë komunistëve e revolucionarëve të botës të dënonin agresionin barbar dhe të solidarizoheshin me çështjen e drejtë të popullit çekoslovak.

Agresioni kundër Çekoslovakisë i kryer nga ushtritë e Traktatit të Varshavës vërtetonte se ky traktat ishte shndërruar plotësisht nga një mjet mbrojtës në një mjet agresioni dhe roberimi, njësoj si blloku agresiv i NATO-s.

Për PPSH dhe për shtetin socialist shqiptar Traktati i Varshavës prej kohësh, që kur u zbulua tradhtia e revizionistëve hrushovianë, nuk ishte më një mjet mbrojtës, por një kërcënim për lirinë dhe për pavarësinë e popullit shqiptar. Në të vërtetë revizionistët e kishin përjashtuar qëkuri Shqipërinë socialiste nga Traktati. Që nga viti 1961 ajo kishte prerë çdo lidhje me të, s'kishte marrë pjesë në asnjë mbledhje të tij. Rrjedhimisht nuk mbante asnjë përgjegjësi për vendimet e veprimet e asaj organizate ushtarake, e cila e kishte manifestuar gjithnjë e më hapur karakterin e vet agresiv. PPSH dhe shteti shqiptar kishin ngritur vazhdimisht zërin kundër këtyre vendimeve e veprimeve në thelb imperialiste të revizionistëve sovjetikë e të satelitëve të tyre të Traktatit të Varshavës. Shqi-

1 Deklaratë e KQ të PPSH dhe të Këshillit të Ministrave të RPSH, 22 gusht 1968. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. V, f. 412.

2 Po aty, f. 413.



përia kishte, pra, të drejtën juridike të dilte prej kohësh nga ky Traktat dhe ta denonconte atë. Pas agresionit brutal kundër Çekoslovakisë PPSH e gjykoj të domosdoshme të priste edhe de jure lidhjet me Traktatin e Varshavës. Ky agresion nxori plotësisht në shesh fytyrën prej fashisti e imperialisti të revizionistëve sovjetikë.

Vendimin për denoncimin e Traktatit të Varshavës e mori Plenumi i KQ të PPSH në mbledhjen e tij të 5 shtatorit 1968. Në koniunkturën që krijoi në gjendjen ndërkombëtare agresioni kundër Çekoslovakisë «ky veprim, — vuri në dukje Plenumi, — është qind për qind në favorin tonë»<sup>1</sup>.

Vendimin për të dalë nga Traktati i Varshavës e për ta denoncuar atë e sanksionoi me ligj të posaçëm Kuvendi Popullor në sesionin e tij të 13 shtatorit 1968. Ky ligj e çlironte juridikisht Shqipërinë socialiste nga çdo detyrim që rridhte prej atij Traktati, në të cilin ajo pati hyrë në maj të vitit 1955.

Ky vendim gjeti menjëherë miratimin e plotë të mbarë popullit, i cili e shprehu këtë miratim me anë të shpërthimit të një vrulli të ri revolucionar për zbatimin e detyrave në fushat e ndryshme të ndërtimit socialist e të mbrojtjes së vendit.

Ky vendim i guximshëm u prit me një ndjenjë solidariteti e admirimi edhe nga opinioni përparimtar e revolucionar botëror.

Denoncimi i Traktatit të Varshavës shprehte vendosmërinë e Partisë e të popullit shqiptar për të vazhduar kursin e tyre marksist-leninist, për të mbrojtur lirinë, pavarësinë kombëtare, socializmin. Ai tregonte gjithashtu se rruga e vetme për mbrojtjen e lirisë, të pavarësisë e të socializmit ishte kundërshtimi i palëkundshëm i politikës hegjemoniste e skllavëruese të imperializmit, amerikan e sovjetik, i luftës së vendosur kundër revizionizmit.

## **Qëndrimi revolucionar i PPSH në marrëdhëniet e Shqipërisë me vendet e tjera**

PPSH përpiqej gjithnjë për vendosjen e marrëdhënieve të drejta të interesit e të dobisë reciproke, pa asnjë përzierje në punët e brendshme, me të gjithë popujt e vendet. Ajo ishte vetëm kundër vendosjes

<sup>1</sup> Dokumente kryesore të PPSH, vëll. V, f. 419.

së marrëdhënieve me dy superfuqitë imperialiste dhe me regjimet fashiste.

Sidomos ajo luftonte mbi baza revolucionare marksist-leniniste për vendosjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve të drejta me fqinjët.

Në maj 1971 u vendosën marrëdhëniet diplomatike midis Shqipërisë dhe Greqisë. PPSH dhe shteti shqiptar kishte vite që bënë përpjekje për këtë çështje, duke u nisur nga realiteti e nga interesat reciproke dhe dëshirat e popullit shqiptar e të popullit grek. Plotësimin e kësaj dëshire e kishin penguar vetëm pretendimet absurde të monarkofashistëve mbi Shqipërinë e Jugut dhe mbi të ashtuquajturën gjendje lufte midis Greqisë e Shqipërisë. Vendosja e marrëdhënieve diplomatike midis të dy shteteve në fakt i jepte fund gjendjes anormale dhe shërbente si bazë për të shpënë përpara miqësinë e bashkëpunimin midis dy popujve fqinj si edhe për forcimin e paqes e të sigurisë në Ballkan.

Politika e fqinjësisë së mirë që ndiqte Shqipëria socialiste kishte shpënë në normalizimin e marrëdhënieve shtetërore me Jugosllavinë, me të cilën kryheshin shkëmbime tregtare e kulturore. PPSH shprehej për përmirësimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve shtetërore në të gjitha fushat ku kishte interesa reciproke. Ajo në shumë raste manifestonte miqësinë e popullit shqiptar me popujt e Jugosllavisë, të krijuar në luftën antifashiste dhe deklaronte se dëshironte t'i shikonte ata të lirë, të pavarur e sovranë dhe se do të ndodhej pranë në përballimin e shantazheve, të kërcënimeve ose të agresionit kundër tyre nga ana e njëres ose tjetrës fuqi imperialiste.

Në të njëjtën kohë, PPSH nuk fshihte kundërshtimet e saj ndaj ideologjisë dhe politikës revizioniste të udhëheqjes jugosllave, përkundrazi vazhdonte me konsekuencë luftën parimore kundër revizionizmit titist, që mbetej gjithnjë një rrezik dhe një armik i marksizëm-leninizmit, i revolucionit dhe i socializmit.

PPSH ngrinte zërin kundër politikës së jashtme prosocial-imperialiste të qeverisë bullgare, vasale e revizionizmit sovjetik, që përbënte një kërcënim kundër Shqipërisë socialiste dhe kundër paqes në Ballkan.

Qenë të njohura synimet ekspansioniste të imperializmit sovjetik në Ballkan. Por PPSH s'mund të pranonte në asnjë mënyrë propozimin që i bëri asaj udhëheqja kineze me anë të

Çu En Lait, më 1968, për të lidhur një aleancë ushtarake me Jugosllavinë e Rumaninë gjoja «për t'u bërë ballë» këtyre synimeve. Udhëheqja e PPSH e hodhi poshtë këtë propozim si një orvatje qëllimkeqe për ta futur Shqipërinë socialiste në kurthin e kompleteve luftënxitëse, si një manovër imperialiste për ta kthyer Ballkanin në një fuçi baruti.

PPSH luftonte për miqësinë dhe mirëkuptimin midis vendeve ballkanike dhe theksonte se kjo miqësi e ky mirëkuptim duhej t'i kenë bazat në popull. Popujt e Ballkanit ishin plotësisht në gjendje të vendosnin vetë në mënyrë sovraane për marrëdhëniet midis tyre. «Fuçi baruti» Ballkanin e kishin bërë në të kaluarën imperialistët. Një politikë të tillë ndiqnin kundrejt Ballkanit edhe tani imperialistët amerikanë me revizionistët sovjetikë. Detyra e popujve ballkanikë, thoshte PPSH, ishte që ta merrnin e ta mbanin vetë gjendjen në dorë, duke prerë lidhjet me paktet e blloqet ushtarake agresive të NATO-s e të Traktatit të Varshavës, që të mund të kishte paqe të vërtetë në gadishull.

Politika e jashtme revolucionare, parimore e konsekuente që ndiqte PPSH dhe shteti shqiptar kishte bërë që të rritej prestigji dhe autoriteti i tyre ndërkombëtar. Në vend që të izolohej siç dëshironin dhe siç luftonin për këtë armiqtë, Shqipëria socialiste e kishte forcuar pozitën e saj në botë. Këtë e vërtetonte edhe lidhja e marrëdhënieve diplomatike midis saj e një varg vendesh të tjera brenda katër vjetëve nga 1968 në 1971. Por më shumë e vërtetonte zgjerimi i përkrahjes dhe i mbështetjes së saj nga ana e forcave revolucionare dhe e popujve lirishtetës të botës, që e shikonin me admirim luftën e guximshme revolucionare e të vazhdueshme, mbi baza parimore, që bënte ajo si në shkallë kombëtare, ashtu e ndër-kombëtare.